



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM  
Nr. 14 datë 26.2.2020**

**“PER MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE  
TEK (ISH KONVIKTIN E SHKOLLËS PYJORE)”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 26.2.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; nenit 30 pika 2 e ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM Nr. 522 Datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”, relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër, me 34 vota pro,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e masës së qirasë mujore për ish konviktin e shkollës pyjore si më poshtë:
  - Qiraja mujore e apartamentit A me sipërfaqe  $56.8 \text{ m}^2 = 3264 \text{ Lekë/Muaj}$ .
  - Qiraja mujore e apartamentit B me sipërfaqe  $88.9 \text{ m}^2 = 5109 \text{ Lekë/Muaj}$ .
  - Qiraja mujore e apartamentit C me sipërfaqe  $96.1 \text{ m}^2 = 5523 \text{ Lekë/Muaj}$ .Bashkëlidhur, shtojca A.
2. Niveli i qirasë është i vlefshëm deri me 31.01.2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**Sekretar i Këshillit**

  
**Denis Lesha**

**KRYETARI**



**Shtojca A:** Metodika e Llogaritje së Masës së Qirasë Për Banesat Sociale me Qira:

Përcaktimi i qirasë mujore për ish konviktin e shkollës pyjore sipas pikës 7 dhe 8 të VKM Nr. 522, Datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira” është si më poshtë:

Kostoja përgjithshme për konviktin e shkollës pyjore sipas pikës 7 të VKM Nr. 522, Datë 25.07.2019, shkresës së Drejtorisë ekonomike të arsimit me nr.72 prot, datë 17.02.2020, certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve me datë 29.12.2016 dhe kërkesës për regjistrimin e pasurisë me datë 08.02.2016, bashkëlidhur është :

<b>Vlera fillestare e objektit e transferuar:</b>	<b>30.952.715 Lekë</b>
<b>Shkalla e amortizimit deri ne 2019:</b>	<b>- 6.546.499 Lekë</b>
<b>Vlera kapitale e transferuar e objektit:</b>	<b>=24,406,216 Lekë</b>
<b>Vlera e rikonstruksionit:</b>	<b>+ 28.236.581 Lekë</b>
<b>Tarifa për regjistrimin e pasurisë:</b>	<b>+ 4.200 Lekë</b>
<b>Kostoja Totale e objektit:</b>	<b>= 52,646,997 Lekë</b>

**Kosto Totale e objektit = 52.646.997 Lekë**

Ish konvikti i shkollës pyjore është një objekt 4 katesh i cili kryen dy funksione, të shërbimit kopsht dhe çerdhe e qendër shëndetësore, dhe të strehimit social. Duke marrë parasysh se qiraja që kërkojmë të përcaktojmë është për strehimin, duhet të përcaktojmë sa është kostoja e sipërfaqes së strehimit në raport me sipërfaqen totale sipas llogaritjes të mëposhtme:

Sipërfaqja totale e objektit është 2290 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja që do përdoren për strehim social është 1577,4 m<sup>2</sup> dhe për të llogaritë koston e sipërfaqes së banimit duhet të përcaktojmë koeficientin që zë kjo sipërfaqe ndaj totalit(1577,4 m<sup>2</sup> / 2290 m<sup>2</sup> = 0.6888).

Aktualishtë kemi 24 apartamente të ndarë në tre grupe:

1. 18 apartamente me sipërfaqe 56.8m<sup>2</sup>.
2. 3 apartamente me sipërfaqe 88.9 m<sup>2</sup>.
3. 3 apartamente me sipërfaqe 96.1 m<sup>2</sup>.

**K<sub>banimit</sub> = 52.646.997 x 0.6888 = 36.263.251 Lekë**

$QV_{total} = 36.263.251 \times 3\% = 1.087.897 \text{ Lekë}$

$QM_{total} = 1.087.897 \text{ Lekë} / 12 = 90.658 \text{ Lekë/Muaj}$

$S_{banimit} = 1577,4 \text{ m}^2$

$S_A = 56.8 \text{ m}^2 \quad P_A = 56.8/1577,4 = 0,036 = 3.6 \%$

$Q_{mA} = 0.036 \times 90.658 = 3264 \text{ Lekë/Muaj}$

$S_B = 88.9 \text{ m}^2 \quad P_B = 88.9/1577 = 0,0564 = 5.64 \%$

$Q_{mB} = 0.0564 \times 90.658 = 5109 \text{ Lekë/Muaj}$

$S_C = 96.1 \text{ m}^2 \quad P_C = 96.1/1577 = 0,061 = 6.1\%$

$Q_{mC} = 0.061 \times 90.553 = 5523 \text{ Lekë/Mua}$

#### Shkurtimet:

**K. Total** = Vlera fillestare e objektit, minus shkallën e amortizimit deri në 2019 plus vlerën e rikonstruksionit plus tarifën e regjistrimit të pasurisë.

$K_{banesa}$  = Kostoja e sipërfaqes së banimit.

$QV_{total}$  = Qiraja vjetore për të gjithë objektin. ( $K \times 3\%$ )

$QM_{total}$  = Qiraja mujore për të gjithë objektin. ( $QV_{total} / 12$ )

$S$  = Sipërfaqja e përgjithshme e banimit.

$S_A$  = Sipërfaqja e një apartamentit tip.

$P$  = Përqindja që zë sipërfaqja e apartamentit ndaj totalit. ( $S_A / S$ )

$Q_{mA}$  = Qiraja mujore e apartamentit tip.

**Sekretar i Këshillit**



Denis Lesha

**KRYETARE**

